



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovec / Municipality of Rahovec
KUVENDI I KOMUNËS / SKUPŠTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 01/22 Nr. i faq./Br.str./No.pg 396
Data/Date/Date 25.11.2022

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konform Shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-508/10 të datës 28.06.2022, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 25.11.2022, merr këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit 01 Nr. 375/22 i datës 23.09.2022 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P-71510033-01041-1 në Zonën Kadastrale Xërxë

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi 01 Nr. 375/22 i datës 23.09.2022 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P-71510033-01041-1 në Zonën Kadastrale Xërxë.
2. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- MAPL-së
- Shërbimit të Kuvendit, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01Nr. 396/22
Datë: 25.11.2022



Dëshirë Kafexhiu
Kryesues i Kuvendit